



**V E N D I M**

***Nr. 113 Date 24.09. 2008***

**PER LIÇENSIMIN E SHOQERISE “HIDROINVEST 1” SH.P.K NE  
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa a, dhe pika 8, si dhe 18 pika 1, germa d, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, 13 dhe 14 , te Rregullores per procedurat e licensimit, te miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve Nr.21, datë 04.04.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator te Energjise (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.09.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqeria “Hidroinvest 1” sh.p.k, per tu licensuar ne aktivitetin e prodhimit te energjise elektrike, per HEC Stranik me fuqi 1600 kW dhe HEC Zall Tore me fuqi 2600 kW,

**Konstatoi :**

- 1- Paraqitjen e plotë te dokumentacionit sipas Rregullores për Procedurat e Liçensimit, nga shoqëria Hidroinvest 1 sh.p.k me date 30.07.2008, për liçensimin për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike.
- 2- Fillimi i procedurave per shqyrtimin e aplikimit te “Hidroinvest 1 ” sh.p.k,, per tu licensuar ne aktivitetin e prodhimit te energjise elektrike per HEC Stranik me fuqi 1600 kW dhe HEC Zall Tore me fuqi 2600 kW, ka nisur me marrjen e vendimit nr. 92 date 06.08.2008
- 3- Rregullorja per procedurat e liçensimit e miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008 në nenin 20 parashikon se për të gjitha aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të kësaj rregullore do të aplikohen rregullat e përcaktuara në rregulloren e procedurave të licensimit të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21 datë 4.4.2007.

Per sa konstatuar, Bordi i Komisionereve te ERE-s,



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



**Vendosi:**

2. Te licensoj shoqerine "HIDRO INVEST 1" shpk ne aktivitetin e prodhimit te energjise elektrike per:
  - a. HEC Stranik me fuqi 1600 kW
  - b. HEC Zall Tore me fuqi 2600 kW
3. Afati i vlefshmerise se licenses te jete 30 vjet.
4. Afati per fillimin e ushtrimit te aktivitetit te prodhimit te energjise elektrike nga te dy HEC-et te jete jo me vone se data 01.10.2009.
5. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftoje aplikuesin per vendimin e ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

**Bujar Nepravishta**

